

UDHËZIM
Nr. 1, datë 7.1.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLA VE TË DETAJUARA PËR NDREQJEN E
GABIMEVE NË AKTET DHE VEPRIMET NOTERIALE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 107, pika 2, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”,

UDHËZOJ:

1. Ndrejja e gabimeve në aktet dhe veprimet noteriale kryhet në rastet dhe sipas procedurës së përcaktuar në pikën 1, të nenit 107, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”.

2. Ndrejja e gabimit në aktin a veprimin noterial përkatës bëhet në çdo kohë, kryesisht nga noteri, kur konstaton gabime ose me kërkesën e palëve që kanë nënshkruar aktin apo veprimin noterial përkatës.

3. Noteri, pas përfundimit të procesit të nënshkrimit elektronik të dokumentit noterial, nuk mund të ndryshojë të dhënat në sistemin elektronik të Dhomës për këtë dokument.

4. Në rast se noteri konstaton gabime materiale, që nuk cenojnë përmbajtjen thelbësore të aktit, pasi bën rregullimin e gabimit në kopjen origjinale, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 107, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, riskanon dhe regjistron në sistemin elektronik të Dhomës aktin e korrigjuar apo vërtetimin e veçantë për ndreqje gabimi, i cili i bashkëngjitet origjinalit, në varësi të rastit.

5. Akti i korrigjuar dhe i certifikuar sërish elektronikisht merr të njëjtin numër repertori dhe numër koleksioni si akti i mëparshëm. Në kopjen elektronike të aktit, në të cilin është konstatuar gabimi, sistemi elektronik shënon statusin “Korrigjuar”.

6. Në sistemin elektronik të Dhomës mbeten të regjistruar të dyja dokumentet noteriale elektronike.

7. Në rast se lind nevoja për të hequr, shtuar, ndryshuar gabimet e konstatuara në aktin apo veprimin noterial, ndryshimi i të cilave është thelbësor për përmbajtjen e aktit apo veprimit noterial, noteri, pasi të ketë bërë rregullimin në tekst, sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 107, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, riskanon dhe regjistron në sistemin elektronik aktin e korrigjuar.

8. Dokumenti në sistem, i korrigjuar dhe i certifikuar sërish elektronikisht, merr të njëjtin numër repertori dhe numër koleksioni si akti i mëparshëm. Në kopjen elektronike të aktit, në të cilin është konstatuar gabimi, shënohet statusi “Korrigjuar”.

9. Në sistemin elektronik të Dhomës mbeten të regjistruar të dyja dokumentet noteriale elektronike.

10. Sistemi elektronik i Dhomës dërgon për regjistrim në kohë reale në sistemin elektronik të Regjistrit Noterial Shqiptar të gjitha aktet dhe veprimet noteriale që regjistrohen në të, të cilat janë ndryshuar/korrigjuar, për shkak të ndreqjes së gabimeve dhe vërtetimet përkatëse të veçanta për ndreqje gabimi.

11. Ndaj çdo veprimi ose vendimi të noterit, për ndreqjen e gabimeve në aktet dhe veprimet noteriale, mund të bëhet ankim në gjykatën administrative kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

12. Për zbatimin dhe ndjekjen e këtij udhëzimi ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)